



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

RREGULLORE

MBI PËRCAKTIMIN E MIRATIMIN E PAGESAVE RREGULLATORE

Miratuar me vendimin e bordit nr. 190, datë 23.11.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.08.2020.

Neni 1

Autoriteti

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga Enti Rregullator i Energjise, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për llogaritjen e pagesave rregullatore për të gjithë të licensuarit në tregun e energjisë si një nga burimet kryesore të financimit të ERE-s, me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të rregullimit.

Neni 3

Objektivi

Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes të pagesave rregullatore është të përcaktojë pagesa rregullatore të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike dhe për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, shpërndarjes së gazit natyror, furnizimit të gazit natyror, tregtimit të gazit natyror, operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së; funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.

Neni 4

Termet e përdorur në metodologji

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin si më poshtë:

- 4.1 **Pagesa rregullatore** – pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror paguajnë për llogari të ERE-s për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore.
- 4.2 **Të Licencuar** – Shoqëri të cilat janë licencuar nga ERE për veprimtaritë sipas pikës

2 të nenit 37 të Ligjit nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar dhe pikës 2 të nenit 22 të Ligjit nr. 102/2015 Për sektorin e gazit natyror, i ndryshuar.

- 4.3 **Të ardhurat** – nënkuptojnë të ardhurat vjetore të realizuara nga aktiviteti I licencuar, të deklaruara në pasqyrat financiare të audituara referuar Standarteve të Kontabilitetit në fuqi.
- 4.4 **Tregu i energjisë** - do të thotë tregut të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror në kuptim të Ligjit nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015 Për sektorin e gazit natyror, i ndryshuar.

Neni 5

Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

- 5.1 Kjo rregullore është konceptuar konform nenit 17 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, ku parashikohet se:
- a. Burimet financiare të ERE-së përbëhen nga pagesat rregullatore, të vendosura nga ajo vetë për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe nga pagesat e licencave.
 - b. ERE mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.
 - c. ERE përcakton dhe miraton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar prej saj.
- 5.2 Pagesa rregullatore, në zbatim të pikës 52 të nenit 3 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe pikës 69 të nenit 4 të Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, llogaritet dhe mbledhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licencuar, pavarësisht faktit nëse në momentin e llogaritjes së kësaj pagese shoqëria nuk e ka filluar aktivitetin për të cilin është licencuar.
- 5.3 Pagesa duhet të jetë në përpjestim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.
- 5.4 Të licencuarit në zbatim të neneve 45 e 46 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 30 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe në zbatim të kushteve të licencës depozitojnë në ERE deri më datë 31 Janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej deri në datë 30 Qershor kopje të audituar të pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullatore.
- 5.5 Pagesat rregullatore do të miratohen jo më vonë se 60 ditë pas miratimit të buxhetit të ERE të vitit aktual.

Neni 6

Përcaktimi i pagesës rregullatore për të licencuarit në sektorin e energjisë

- 6.1 Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i çdo të licencuari në vitin paraardhës ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror të realizuar për të njëjtën periudhë.
 - 6.1.1 Të ardhurat për efekt të llogaritjes së pagesave rregullatore do të konsiderohen:
 - a. **Për shoqëritë e prodhimit të energjisë elektrike** - të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar.
 - b. **Për shoqëritë e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike/gazit natyror** - të ardhurat (vlera e shtuar) të realizuara nga shit-blerja e energjisë elektrike/gazit natyror.
 - c. **Për shoqëritë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike/gazit natyror**- të ardhurat (vlera e shtuar) të realizuara nga shit-blerja e energjisë elektrike/gazit natyror.
 - d. **Për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e operatorit të tregut të energjisë elektrike/gazit natyror** - të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar.
 - e. **Për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror**- të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar.
- 6.2 Pagesa rregullatore për secilin të licensuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t'u shpërndarë në buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga të licencuarit) të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
- 6.3 Për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror që në vitin paraardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 100 mijë lekësh.
- 6.4 Në rastet kur një shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike apo gazit natyror, nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, atëherë ERE do të përlllogaritë këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga Publikime Zyrtare.

Neni 7
Korrigjimi

ERE, me paraqitjen e një kërkesë nga të licencuarit në rast të pasaktësive të llogaritjes në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i licencuar, rillogarit dhe korrigjon pagesën rregullatore të vitit aktual në pagesën rregullatore të vitit pasardhës.

Neni 8
Njoftimi

- 8.1 ERE pasi përcakton pagesat rregullatore njofton të licencuarin për vlerën, afatet e pagesës për vitin ushtrimor, vëndin e kryerjes së këtyre pagesave dhe penalitetet në rast se kjo pagesë nuk kryhet në kohë.
- 8.2 Pagesat rregullatore depozitohen nga ERE në një llogari të veçantë, të hapur në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9
Penalitetet

- 9.1 Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit të ERE mbi përcaktimin e pagesës rregullatore, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 106 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
- 9.2 Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundravajte administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1 gërma (b) nenit 107 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe pikës 1 gërma a) (ii) të nenit 106 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.
- 9.3 Në rast se i licencuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1. e 9.2 të këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licencës, siç përcaktuar në pikën 1 (ç) të nenit 42 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe pikës 1 (ç) të nenit 27 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë, është objekt ndryshimesh apo rishikimi vetëm me vendimin e Bordit të ERE.